



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 374 Prot

Tiranë, më 24, 12, 2014

VENDIM Nr. 367 datë 12.12.2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.12.2014, pasi shqyrtoi "Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik" për projektin "Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë", OST, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik për projektin "Ndërtimi i linjës së transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë", OST .
- II. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrje arkeologjike periodike nga DRKK Shkodër, në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Të realizohen sondazhe arkeologjike nga Misioni Arkeologjik Shqiptaro-Francez për shtyllat e projektit "Ndërtim i linjës së transmetimit 400 kv Shqipëri-Kosovë", OST, të cilat pozicionohen brenda zonës "B" të " Zonës së mbrojtur Koman", të propozuar nga Misioni Arkeologjik Shqiptaro-Francez i Komanit.
- IV. Të lidhet aktmarrëveshje trepalëshe ndërmjet Institutit të Arkeologjisë (Misionit Arkeologjik Shqiptaro-Francez të Komanit), Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe OST, në lidhje me sondazhet që do të kryhen në zonën e "B" të " Zonës së mbrojtur arkeologjike Koman", të propozuar nga Misioni Arkeologjik Shqiptaro-Francez i Komanit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

